

## KONVENTA PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

### *Grupi i Punës II (Drejtësia, Liria dhe Siguria)*

**Tema: "Krimi kibernetik dhe siguria kibernetike në Shqipëri : Sfidat e reja në kuadër të procesit të integrimit"**

*E martë 24 maj 2016*

#### Zhvillimet Aktuale

Ndërkohë që teknologjia digjitale dhe interneti cilësohen nga BE si një hallkë e rëndësishme e shoqërisë dhe ekonomisë europiane, sistemet e informim dhe rrjetet e komunikimit mund të cenohen nga incidente të shumta që mund të jenë të natyrës njerëzore, teknike apo të sulmeve të qëllimshme, që tashmë janë bërë gjithnjë e më të mëdha. Për këtë siguria e këtyre rrjeteve të komunikimit e shkëmbimit të informacionit merr një rëndësi të veçantë.

Shqipëria renditet ndër vendet ku zhvillimi i telekomunikacionit, qasja në internet dhe informatizimi i shoqërisë përparon shumë shpejt. Miratimi i një sërë ligjesh në këtë fushë si Ligji Nr. 9880 datë 25.02.2008 "Për certifikimin elektronik", Ligji Nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", Ligji 10128 datë 11.05.2009, "Për tregtinë elektronike", Ligji Nr. 10325 datë 23.09.2010 "Për Bazat e të Dhënave Shtetërore", Ligji Nr. 72 2012 datë 28.06.2012 "Për organizimin dhe funksionin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH" dhe një sërë aktesh nënligjore në vijim të tyre kanë sanksionuar edhe ligjërisht përfshirjen e Shqipërisë në këtë qasje të re globale.

Rreziqet për fëmijët gjatë përdorimit të internetit mund të jenë të shumta, në varësi të moshës, fazës së zhvillimit dhe mënyrës sesi lidhen në internet, të tilla si: ngacmimi virtual, takimi me njerëz të panjohur, ekspozimi ndaj përmbajtjes pornografike, lojërat online, si dhe keqpërdorimi i të dhënave personale. Që prej vitit 2012 në Shqipëri me iniciativën e Ministrisë përgjegjëse për informimin e inovacionin zhvillohet Java për Internet të Sigurt ku synohen një sërë fushatash ndërgjegjësuese për fëmijët, prindërit për një internet të sigurt. Kuadri ligjor është rregulluar përmes miratimit të një sërë ligjesh si Ligj Nr 9834 datë 22.11.2007 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë, Ligji Nr. 10 071 datë 09.02.2009 'Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual' apo Ligji Nr. 10 437 datë 04.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të

fëmijës”. Ndërkohë ne vitin 2012 u ndërmor iniciativa për hartimin e një drafti për Internet më të sigurt, dhe nënshkrimi i Kodit Etik për të bashkëpunuar për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme ne Internet

Por rritja e përdorimit të komunikimit online ndonëse përbën një vlerë të shtuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, në të njëjtën kohë, ajo e ekspozon atë ndaj rreziqeve të natyrës kibernetike me aktorë shtetërorë dhe jo shtetërorë. *Sulmet kibernetike* kanë potencial për të dëmtuar rëndë shkëmbimin e informacionit në institucionet publike, të telekomunikacionit dhe sistemin financiar e bankar, duke shkaktuar edhe ndërprerje të shërbimeve jetike. Për tu përballur me çështjet e sigurisë së krimit kibernetik, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë hapash të karakterit institucional e ligjor në përpjekje për tu përballur me këtë fenomen.

Që prej vitit 2002 Shqipëria ka nënshkruar *Konventën e Këshillit të Europës* përmes Ligjit Nr. 8888 datë 25.04.2002 “Për ratifikimin e Konventës për Krimin në Fushën e Kibernetikës”. Takime intensive janë zhvilluar me përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë për Krime të Rënda dhe Policisë Shkencore lidhur me Protokollin e Hetimit të veprave penale të krimit kibernetik. Sektori i Hetimit të Krimit Kibernetik në Prokurorinë e Përgjithshme është ngritur me afro 10 prokurori e në Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe Sektori i Krimit Kibernetik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Departamentin e Krimit Ekonomik për të hetuar 18 vepra penale të parashikuara nga Kodi Penal.

Në vitin 2011 qeveria shqiptare krijoi Agjencinë Kombëtare të Sigurisë Kompjuterike, me anë të VKM Nr. 766 datë 24.09.2011. Nga ana tjetër qeveria shqiptare hartoi edhe një sërë dokumentesh politikash e strategjish ku spikat veçanërisht hartimi i një strategjie në nivel kombëtar për sigurinë kibernetike dhe nënvizimi i aspektit të sigurisë kibernetike si rrezik i nivelit të parë në *Strategjinë e Sigurisë Kombëtare* (Ligji Nr. 103/2014 datë 31.07.2014 “për Miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të RSH”). Njëkohësisht kjo qasje u përforcua më tej me Dokumentin e Politikave për Sigurinë Kibernetike që u miratua përmes VKM Nr. 973 datë 02.12.2015 duke pasur parasysh që prej anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, infrastrukturat kritike kibernetike të qarkullimit e shkëmbimit të informacionit mes agjencive të ndryshme të sigurisë apo edhe shërbimit të jashtëm kanë nevojë për protokolle të veçanta sigurie

Aktualisht momenti më i rëndësishëm është diskutimi i *Projektligjit për Sigurinë Kibernetike* që pritet të përshtatet me Direktivën e re të BE për Sigurinë Kibernetike për të cilën Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Agjencia e Sigurisë Kibernetike do të nisin një proces konsultimi me aktorë të ndryshëm. Në procesin e integrimit të Shqipërisë për në Bashkimin Europian, Shqipëria raporton për aspekte të sigurisë kibernetike si pjesë e kapitullit 10 Shoqëria e Informacionit ndërkohë që raporton për krimin kibernetik në kapitullin 24 që lidhet me çështjet e sigurisë së brendshme.

## Problematika dhe Rekomandime

### → *Plotësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor për sigurinë kibernetike*

- Procesi i dixhitalizimit është sfidues jo vetëm në hartimin e ligjeve por më së shumti në zbatimin e kuadrit ligjor. Një hap pozitiv i shtetit shqiptar lidhet si **me miratimet e ligjeve të ndryshme** si Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për Komunikimet Elektronike apo ai për Tregtinë Elektronike, ashtu edhe me nënshkrimet e një sërë marrëveshjesh dhe konventash ndërkombëtare siç është ai ratifikimi i Konventës Europiane mbi Krimin Kibernetik në vitin 2002.
- **Nuk mund të realizohet** dot harmonizimi i plotë i ligjit me acquis european pasi ky proces duhet të jetë gradual dhe duhet të bazohet edhe në kontekstin shqiptar. Siç është rasti i të drejtave të autorit në internet, që nëse në Europë vlerësohet si vepër penale në Shqipëri akoma nuk është përfshirë në Kodin Penal.
- Vështirësia me Ligjin në fushën e sigurisë kibernetike qëndron dhe te fakti **që është një legjislacion i ri dhe dinamik**, pasi edhe fusha është e tillë që ndryshon me shpejtësi. Vështirëson faktin që shteti shqiptar të jetë gjithmonë me të njëjtin hap me përditësimet dhe ndryshimet legjislative të BE-së.
- **Mungon informacioni i duhur i subjekteve dhe personave mbi legjislacionin** rreth sigurisë dhe krimit kibernetik. Siç është edhe Rasti i Ligjit për Tregtinë Elektronike, ku subjektet që ofrojnë këtë shërbim nuk e dinë që janë të prekur nga detyrimet e këtij ligji.
- *Draft Ligji për Sigurinë Kibernetike* duhet të ketë si fokus dy momente kryesore: 1. Krijimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe 2. Listimi i infrastrukturave të informimit që cilësohen si kritike.
- **Procesi i Identifikimit të strukturave kritike** është një metodë e re e futur në Shqipëri. Përditësimi i informacionit duhet të bëhet të paktën një **herë në dy vjet** dhe duhet që të raportohen incidentet për të gjitha strukturat kritike. Për shkak të karakterit të tyre ndërlihdës mund të rrezikohet i gjithë sistemi. Edhe pse BE ka një **listë indikatorësh për këto struktura kritike** ato duhet të përshtaten me zhvillimin teknologjik dhe atë të institucioneve shqiptare. Kështu që disa nga këto indikatorë si kërkimi hapësinor mund të injorohet pasi nuk gjen zbatim në Shqipëri. Gjithashtu indikatorë të rinj mund të krijohen siç është siguria dhe rendi publik, që janë prioritare në Shqipëri.

### → *Forcimi i kapaciteteve njerëzore e teknike për të luftuar krimin kibernetik*

- Kapacitetet njerëzore të në këtë drejtim janë të pakta dhe mungojnë. Fokusi duhet jo vetëm në trajnimet e ekspertëve të policisë por edhe **atyre të sistemit gjyqësor si dhe prokurorëve duke thelluar dhe bashkëpunimin** mes institucioneve.
- Rekomandohet që të **trajnohen të paktën një gjyqtar dhe një prokuror** për çdo rreth gjyqësor mbi sigurinë kibernetike dhe krimin kibernetik, që dhe koordinimi i punës të jetë më i thjeshtë mes policisë dhe institucioneve të hetimit dhe gjykimit në të gjithë vendin.

- Duhet ndërtuar një **rrjet informatorësh si brenda dhe jashtë vendit** për një shkëmbim informacioni më të shpejtë dhe të saktë. Gjatë bashkëpunimeve duhet të krijohen ato që njihen si 'contact point'.
- Me rëndësi që punonjësit e policisë dhe institucioneve të tjera të kenë njohuri mjaft të mira jo vetëm teknike dhe ekspertizë të lartë të fushës, për të ditur si funksionon por një domosdoshmëri shfaqet dhe **niveli i lartë i njohjes së gjuhës angleze**. Për këtë mund të realizohen dhe trajnime brenda institucioneve të policisë.
- Trajnimet edhe me ekspertë të **policive europiane apo ndërkombëtare** si Europol apo Interpol shkëmbim eksperiencash, metodash se si të dallohet krimi kibernetik dhe si të hetohet ai. Kjo është e nevojshme edhe për gjyqtarët dhe prokurorët për të dhënë më pas të gjithë informacionin e nevojshëm.

➔ *Bashkëpunimi me aktorë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar*

- Me **sektorë të tjerë të shoqërisë dhe ekonomisë** si sektori i bankave, apo subjekte të tjera elektronike. Për shkëmbim informacioni për kërcënimet dhe problemet që mund të kenë hasur. Për këtë mund të bëhen takime mes policisë dhe përfaqësuesve të këtyre sektorëve për shkëmbim informacioni por edhe për të gjetur ura bashkëpunimi dhe koordinimi.
- Me **shoqërinë civile dhe organizata jo qeveritare**, për të mundësuar fushata informimi me anë të spoteve publicitare apo broshurave të ndryshme, apo sesioneve informuese. Këto organizata kanë edhe strukturat e duhura për të mundësuar numra kontakti apo faqe online për informim dhe raportim incidentesh.
- Me **institucionet arsimore** që mund të ndihmojnë në edukimin dhe informimin sidomos të **fëmijëve dhe të rinjve** që mund bëhen pre e rreziqeve kibernetike përfshirë edhe pornografinë
- Më shumë bashkëpunim edhe me **ato subjekte dhe struktura që duhet të ruajnë** informacionin elektronik dhe duhet ta ndajnë atë në rast rreziku apo kërcënimi.
- Me **autoritetet ndërkombëtare** ku vihet re që **policia e shtetit shqiptar** ka një kooperim të mirë me Europolin dhe Interpolin, kjo ka rëndësi edhe për shkak të vetë natyrës së krimit kibernetik që nuk njihet kufij.

➔ *Informimi dhe Monitorimi për një internet më të sigurt*

- Mungon vëmendja ndaj këtij sektori, pak flitet dhe diskutohet kjo edhe për faktin e karakterit të tij specifik dhe teknik. Kërkohen më shumë **fushata sensibilizimi dhe informimi mbi rrezikun kibernetik** dhe si të mbrohemi prej tij.
- Është i nevojshëm një proces i vazhdueshëm dhe periodik **mbikëqyrjeje dhe monitorimi për sa i përket subjekteve dhe ngjarjeve kompjuterike** dhe për këtë duhet edhe një regjistër i veçantë për të vendosur dhe incidentet kibernetike, edhe raportimet.

## Pjesëmarrësit në Sesionin 4 të Grupit të Punës II: Institucione Shtetërore dhe Shoqëri Civile

### Institucione Shtetërore:

**Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike:** Znj. Irena Malolli, Znj. Vilma Tomço, Znj. Elda Zenelaj

**Policia e Shtetit:** Znj. Suela Bonjaku, Znj. Luljeta Ismajlukaj

**ALCIRT:** Znj. Jona Josifi

**AKSHI:** Znj. Eranda Begaj

**AKTI :** Z. Geron Kamberi

**Shërbimi Ligjor Falas:** Znj. Vilma Gjeçi

### Shoqëri Civile dhe Akademia:

**UNICEF:** Znj. Floriana Hima, Znj. Ilaria Favero,

**Shoqata Zëri i Fëmijëve dhe Grave:** Znj. Shega Murati

**Universiteti i Tiranës :** Z. Petrit Sadedini,

**Universiteti i Prishtinës :** Z. Granit Hoxha, Znj. Klodiana Dushaj

### Media:

**Ora News:** Znj. Lunada Methasani

**TVSH**